



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:100564

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05512283

A.nr.1178/2021

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, Luljeta Maxhuni, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit,, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, kundër paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Administratës Pensionale, Departamenti i Pensioneve, Prishtinë, me bazë juridike anulimi i vendimit, në prezencë të autorizuarit të paditësit, e në mungesë të paditurës, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe publik, të mbajtur më datën 26.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësit,, ndërsa **ANULOHET** vendimi i të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve-Departamenti i Administratës Pensionale, Departamenti i Pensioneve, me nr. të dosjes 340479 të datës 29.10.2020, dhe lënda i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

II. Obligohet e paditura MFPT/DP, të veprojë nga pikëpamja juridike e kësaj gjykate si dhe nga vërejtjet e dhëna lidhur me procedurën.

A r s y e t i m

Seanca e shqyrtimit kryesor është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prezencë të autorizuarit paditësit, e në mungesë të paditurës, e ftuar në mënyrë të rregullt nga gjykata.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij sipas padisë së parashtruar në këtë gjykatë më 25.05.2021, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovet kërkesëpadia si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditurës i datës 29.10.2020 me numër të dosjes 340479 dhe çështja të kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim tek e paditura apo çështje të vendoset nga gjykata dhe paditësit të pranojë të drejtën e pensionit kontribut pagues në bazë të kualifikimit me fakultetin juridik nga data 09.03.2020, e në të ardhmen në shume mujore të paraparë me ligj.

Ndërsa i autorizuari i në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se, mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së tij, duke kërkuar nga gjykata të anulohet vendimi i të paditurës pasi që paditësi i ka 15 vite përvojë pune në kategorinë e katërt (4) me përgatitje Superiore. Meqenëse edhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese është përcaktuar që neni 8 i Ligjit për Skemën e Pensioneve Kontributpaguese është diskriminues. Edhe pse paditësi sipas dëshmive i ka mbi 18 vite përvojë pune. Kështu që i plotëson dyja kushtet e parapara ligjore për pension kontributpagues. Pra moshën 65 vjet dhe stazhin 15 vite. Kërkoj nga gjykata që çështja të kthehet në rivendosje tek e paditura.

E paditura, përmes përgjigjes në padi të parashtruar në këtë gjykatë më 22.03.2024, e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Sipas të paditurës, paditësi pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar me as edhe një provë të vetme, ndërsa vendimi i kontestuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi. I ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin e të paditurës.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor më 26.03.2024, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i dt.06.04.2020; Ankesa e dt.11.12.2020; vendimi i dt.29.10.2020 me numër 340479; Kopja e librezës së punës numër 14440; Vërtetimi i dt.25.07.2019; aktvendimi 23.05.1993 numër 49/93; librezë e dt.23.04.1993; vërtetimi i dt.25.07.2019; vendimi i dt.09.07.2015 numër 01-533 dhe kopja e diplomës për paditësin e dt.18.04.1979 numër 3374.

Me vendimin kontestues të paditurës, është refuzuar ankesa e paditësit për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues të moshës, me konstatimin mes tjerash se është vërtetuar se nuk janë plotësuar kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues konform nenit 8 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka parashtruar padi në gjykatë, duke kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata kishte parasysh Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, konkretisht nenin 8 të këtij ligji të referuar në vendimin e atakuar i cili përcakton se: “Të drejtën në pension kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët; 1.1. Kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 1.2. Duhet të ketë stazh pensional kontributdhënës, sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 26/83) para datës 01.01.1999; 1.3. Ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK NR. 26/83) para datës 01.01.1999”.

Me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet: “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, i njëjti nuk përmban elementet nga neni 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ligj ky i aplikueshëm në periudhën e ankimit dhe shqyrtimit të çështjes pranë organit administrativ. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm: “pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës është vërtetuar se nuk janë plotësuar kriteret për njohjen e të drejtës në pensionim kontributpagues konform nenit 8 të Ligjit 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti ngase nuk janë prezantuar dëshmi të mjaftueshme në kuptim të Ligjit të cekur më lartë për 15 vite stazh kontributi.

Andaj një arsyetim i tillë fillimisht nuk paraqet asnjë pretendim të paditësit, nuk jepen arsye konkrete për pretendimin e paditësit, pra nuk përmendet asnjë provë e shqyrtuar në bazë të së cilës është vërtetuar ndonjë fakt, me cilat prova i ka konstatuar faktet vendimtare dhe mbi cilën bazë ligjore është mbështetur për të ardhur te konstatimi se nuk janë prezantuar dëshmi të mjaftueshme, në arsyetim referohet dispozita ligjore por nuk arsyeton se pse është e zbatueshme në rastin konkret.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe të ketë parasysh provat në shkresat e lëndës.

E paditura duhet të ketë në vëmendje në procedurën e rivendosjes po ashtu Ligjin nr.08/L-248 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, (i cili ka hyrë në fuqi me dt.16.08.2023, e që nuk ka qenë në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit kontestues nga e paditura), veçanërisht nenin 4 të të njejtij Ligj, ku është përcaktuar: “Pas nenit 8, shtohet dispozita ligjore 8/A në Ligjin Bazik me tekstin si në vijim”: Neni 8/A - Pensioni parcial kontribut pagues i moshës:1. Personat që kanë kontribuar sipas Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor Nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK Nr. 26/83) para datës 01.01.1999 por nuk e arrijnë stazhin pensional prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh kontribute si periudhë kushtëzuese për shkak se janë larguar nga puna si rezultat i masave të dhunshme, mund të kualifikohen në skemën e pensionit parcial kontribut pagues të moshës sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në këtë nen.2. Të drejtën në pension parcial kontribut pagues të moshës e realizojnë të gjithë personat të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët plotësojnë kushtet në vijim: 2.1. kanë mbushur moshën gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeçare; 2.2. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr.011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; 2.3. janë larguar nga puna pas datës 01.01.1989 si rezultat i masave të dhunshme; 2.4. shuma e periudhës së kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 si dhe periudhës nga data e largimit të dhunshëm nga puna sipas nën-paragrafit 2.3 e deri më 01.01.1999 bashkërisht arrijnë nivelin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh. 3. Dokumentacioni i nevojshëm për të plotësuar kushtet e paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet me akt nënligjor nga ministri. 4. Lartësia e pensionit parcial kontribut pagues për secilin nivel përcaktohet në përputhje me procedurën e vendosur me nenin 13 të Ligjit Bazik, duke marrë për bazë numrin e viteve të kontributeve të paguara sipas nën-paragrafit 2.2 të këtij neni.

Gjykata si rregull konfliktin administrative e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Në këtë mënyrë, vendimi konsiderohet se përmban të meta për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkëljet thelbësore të dispozitave ligjore, të cilat pamundësojnë shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit ose edhe vendosjen në mënyrë meritore nga ana e gjykatës, andaj, gjykata konform nenit 43.2 të LKA-së, vendosi që çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veprorë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr aktvendim të drejtë, të bazuar, udhëzues për palën paditëse në mbrojtje juridike dhe palët të njoftohen me kohë.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 5,6, 38, 43 dhe 46.2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr.1178/2021, më 26.03.2024

Gj y q t a r e

Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.